

Termocentrali Vlorë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shenime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	5	10,692,163,125	11,273,429,155
Aktivitet afatgjata jomateriale		-	
Total aktiveve afatgjata		10,692,163,125	11,273,429,155
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	6	1,193,296,621	1,189,486,898
Llogari te arketueshme	7	381,764,819	866,177,223
Mjetet monetare ne arke e ne banke	8	745,180,253	756,315,449
Total aktive afatshkurtra		2,320,241,693	2,811,979,570
Total aktive		13,012,404,818	14,085,408,725
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar		31,204,000	31,204,000
Rezerva rivleresimi			
Rezerva te tjera		225,747,682	225,747,682
Rezerva ligjore		1,560,200	1,560,200
Fitime/humbje te mbartura		(8,924,079)	-
Fitimi i ushtrimit		(1,516,222,792)	(8,924,079)
Total kapitali aksionar	9	(1,266,634,989)	249,587,803
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	7,694,740,765	9,246,264,653
Grante,te ardhura te shtyra te tjera detyrime	11	59,184,004	62,613,679
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Total detyrime afatgjata		7,753,924,769	9,308,878,332
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	6,459,288,433	4,450,491,131
Llogari te pagueshme tregëtare	13	58,529,156	29,127,559
Detyrime tatimore	14	2,108,826	24,162,520
Llogari te pagueshme te tjera	15	5,188,623	23,161,380
Total detyrime afatshkurtra		6,525,115,038	4,526,942,590
Totali i detyrimeve		14,279,039,807	13,835,820,922
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		13,012,404,818	14,085,408,725

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI
Administrator | TEC Vlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike

Termocentrali Vlorë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	-	1,409,604,000
Te ardhura te tjera	17	3,691,132	2,250,431
Total te ardhura		3,691,132	1,411,854,431
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	18	(15,033,447)	(13,690,355)
Shpenzime personeli	19	(64,307,673)	(62,186,835)
Shpenzime zhvleresimi dhe amortizimi	20	(1,082,541,249)	(622,018,870)
Shpenzime te tjera te shfrytëzimit	21	(72,683,789)	(91,224,675)
Total te shpenzime		(1,234,566,158)	(789,120,735)
Shpenzime interesi dhe te ngjashme	22	(249,410,274)	(318,684,273)
Shpenzime te tjera financiare	23	(35,937,492)	(311,035,432)
Fitimi/humbja para tatimit		(1,516,222,792)	(6,986,010)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			(1,938,069)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	24	-	(1,938,069)
Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre			
Fitimi/humbja e vitit		(1,516,222,792)	(8,924,079)
Te ardhura te tjera gjithperفشیرهه per vitin:		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithperفشیرهه per vitin		(1,516,222,792)	(8,924,079)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI
Administratori i TECVlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike

Termocentrali Vlorë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i aksionar	Rezerva Ligjore	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva të tjera	Fitim/humbjet e mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2014	31,204,000	-	-	-	(108,236,807)	335,544,689	258,511,882
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:							
Transferim në rezerva		1,560,200		225,747,682		(8,924,079)	(8,924,079)
Transferim në fitim/humbjet e mbartura					108,236,807	(227,307,882)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	31,204,000	1,560,200	-	225,747,682	-	(8,924,079)	249,587,803
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:							
Transferim në rezerva						(1,516,222,792)	(1,516,222,792)
Rezerva rivlerësimi					(8,924,079)	8,924,079	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	31,204,000	1,560,200	-	225,747,682	(8,924,079)	(1,516,222,792)	(1,266,634,989)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori më ____ Mars 2016 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Besnik KENDEZI
Administratori TECVlore sh.a

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike



1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 3862 ,date 18.06.2007 si dhe është regjistruar në QKR më datën 22.12.2007.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi , importi , eksporti dhe furnizimi i energjisë elektrike . Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Portin e ri, "Komuna Qender" , Vlorë. NIPT-i i Shoqërisë është K72422003G . Administratori i Shoqërisë është Z.Besnik Këndezi .

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015.

- SNRF 2 – qartëson përcaktimin e "Konditës së kushtëzimit" dhe bën dallimin ndërmjet 'kushtit të performancës' dhe 'kushtit të shërbimit'.
- SNRF 3 – qartëson se një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar klasifikohet si detyrim financiar ose si kapital bazuar në parimet e SNK 32 (Instrumentet Financiarë: Paraqitja) dhe se e gjithë shumta e kushtëzuar (detyrim financiar ose jo) matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi.
- SNRF 3 – qartëson se SNRF 3 nuk gjen zbatim në kontabilizimin e lidhjeve të marrëveshjeve të përbashkëta.
- SNRF 8 – kërkon shënime shpjeguese sa i përket gjykimeve të Menaxhimit në lidhje me konsolidimin e segmenteve të aktivitetit të kompanisë dhe qartëson se për një rakordim të segmenteve të aktiveve mund të jepen shpjegime vetëm nëse segmentet e aktiveve bëhen të njohura.
- SNRF 13 konfirmon se llogaritë e arkëtueshme apo të pagueshme afatshkurtra mund të vazhdojnë të maten me vlerën e faturuar nëse impakti nga skontimi është jomaterial.
- SNRF 13 - sqaron se përjashtimet në SNRF 13 (matja e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh dhe detyrimeve financiare mbi bazë neto) zbatohet për të gjitha kontratat brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9
- SNK 16 dhe SNK 38 – sqarojnë se si trajtohen vlera e mbetur dhe amortizimi i akumuluar në rastin kur një entitet kryen rivlerësim të aktiveve.
- IAS 24 – sqaron se kur një entitet merr shërbime menaxhimi nga personeli i një pale të tretë (një entitet menaxhimi), tarifat e paguara për ato shërbime duhet të pasqyrohen në shënimet shpjeguese nga entiteti raportues, por jo pagesa që entiteti i menaxhimit i bën punonjësve apo drejtorëve të tij.
- IAS 40 – sqaron se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht ekskluzive në bërjen e dallimit midis pronës së investimit dhe pronës që shfrytëzohet nga pronari dhe përcaktimin nëse blerja e një prone investimi mund të cilësohet si një kombinim biznesi.

Amendimi ndaj SNK 19 – "Përfitimet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014). Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përfitimeve e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përfitimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përfitimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (Vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

Deri më datë 30 prill 2015, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2015:

- *Amendimi ndaj SNRF 9 – “Instrumentat Financiare” (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare që fillojnë më 1 shkurt 2015).*
- *Amendimi ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 – “Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në një sipërmarrje të përbashkët” (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektive të shtyrë derin në një deklaram të dytë).*
- *Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 – “Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).*
- *Amendimi ndaj SNRF 11 – “Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).*
- *SNRF 14 – “Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore” (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).*
- *SNRF 15 – “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht)*
- *Amendimi ndaj SNK 1 – “Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).*
- *Amendimi ndaj SNK 16 dhe SNK 38 – “Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016).*
- *Amendimet ndaj SNK 16 dhe SNK 41 – “Bujqësia: Bimët Bartëse” (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas dates 1 janar 2016).*
- *Amendimi ndaj SNK 27 – “Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale” (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).*

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Në vitin 2015, ndryshe nga vitet e mëparshme, duke qënë se Termocentrali Vlore ("TEC") nuk është në funksion Enti Rregullator i Energjisë ("ERE") nuk i ka miratuar një cmim prodhim të energjisë dhe për pasojë as kuotën fikse mbi bazën e të cilit TEC-i financohej nga Korporata Energjitike Shqiptare.

Peë rrjedhojë në vitin 2015 shoqëria nuk ka realizuar të ardhura dhe është me rezultat negativ.

Në rast të vazhdimit të mos funksionimit të TEC-it, shoqëria mund të vendoset përballë vështirësive financiare dhe bllokimit të aktivitetit të saj.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)**4.4. Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	50 vite
Ndërtime dhe instalime	20-50 vite
Makineri dhe pajisje	15-25 vite
Mjete transporti	5 vite
Paisje zyre, orendi dhe pajisje informatike	4 vite

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Të ardhurat (vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike është e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur.

ERE per periudhen deri ne fund te vitit 2014 ka aprovuar çmimin e shitjes së energjisë brenda kontekstit të modelit të tregut ku Shoqëria optimizon aktivet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme. Çmimi i shitjes për periudhën Janar-Dhjetor 2014 ka qenë 21.4 Lekë/kwh.

Sipas vendimit nr. 161 prot . Date 07.12.2012 të ERE-s, Shoqërisë i ishte miratuar çmimi i tregtimit të energjisë prej 21.4 lekë/kwh për vitin 2014.

Për vitin 2015 Shoqëria nuk ka kuota të caktuara nga ERE.

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

	Ndërtesa	Ndërtime dhe instalime	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje Kompiuterike	Pajisje zyre	Totali
Kosto							
Gjendja më 01 janar 2014	243,037,367	2,354,562,445	10,608,357,071	2,729,971	1,677,231	2,633,614	13,212,997,699
Shtesa		1,140,920		1,027,500	305,100	85,000	2,558,520
Pakesime		(214,468)			(256,152)	(57,000)	(527,620)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	243,037,367	2,354,562,445	10,609,283,523	3,757,471	1,726,179	2,661,614	13,215,028,599
Shtesa			5,648,600			452,500	6,101,100
Transferime				(1,027,500)		(72,500)	(1,100,000)
Pakesime							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	243,037,367	2,354,562,445	10,614,932,123	2,729,971	1,726,179	3,041,614	13,225,721,699
Zhvleresimi dhe amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 01 janar 2014	10,815,163	192,407,758	1,112,363,836	1,490,547	1,021,029	1,052,757	1,319,151,090
Amortizimi i vitit	4,982,266	95,474,717	520,789,448	262,441	191,253	318,745	622,018,870
Pakesime			(65,770)	736,375	(217,182)	(23,939)	429,484
Gjendja më 31 dhjetor 2014	15,797,429	287,882,475	1,633,087,514	2,489,363	995,100	1,347,563	1,941,599,444
Amortizimi i vitit	4,860,747	90,910,255	490,522,549	332,593	182,770	263,401	587,072,315
Transferime							
Pakesime				(805,184)			(805,184)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	20,658,176	378,792,730	2,123,610,063	2,016,772	1,177,870	1,610,964	2,527,866,575
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2014	227,239,938	2,066,679,970	8,976,196,009	1,268,108	731,079	1,314,051	11,273,429,155
Gjendja më 31 dhjetor 2015	222,379,191	1,975,769,715	8,491,322,060	713,199	548,309	1,430,650	10,692,163,125

6. Inventarë

Balanca e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Naftë	1,117,957,358	1,121,049,917
Materiale	75,215,378	68,310,121
Inventar i imët	123,885	126,860
	<u>1,193,296,621</u>	<u>1,189,486,898</u>

7. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Technimont	2,451,803	2,451,804
TVSH për t'u rimbursuar	37,811,116	37,811,116
Tatim fitimi i parapaguar	11,023,872	
Akzize për t'u rimbursuar	825,781,559	825,781,559
Të arkëtueshme nga KESH sh.a		
Të tjera të arkëtueshme	165,404	132,744
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme për akcizën	(495,468,935)	
	<u>381,764,819</u>	<u>866,177,223</u>

8. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	745,180,253	756,315,449
Llogari rrjedhëse	2,157,246	7,164,338
Depozita me afat	743,023,007	749,151,111
Mjete monetare në arkë	-	-
	<u>745,180,253</u>	<u>756,315,449</u>

9. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion . Aksionet zotërohen 100% nga Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare .

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri aksioneve	31,204	31,204
Vlera nominale(në Lekë)	1,000	1,000
	<u>31,204,000</u>	<u>31,204,000</u>

Rezervat ligjora nuk kanë pësuar ndryshime , ato janë në vlerën 1,560,200 Lekë.

Rezervat e tjera të Shoqërisë nuk kane pasur ndryshime dhe janë në vlerën 225,747,682 Lekë

. Fitim/humbjet e mbartura janë në në vlerën (8,924,079) Lekë. (2014: 0 Lekë)

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohet si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua afatgjata nga Korporata Elektroenergjitike	7,694,740,765	9,246,264,653
Shqiptare	<u>7,694,740,765</u>	<u>9,246,264,653</u>

11. Grante ,të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Grante të marra	59,184,004	62,613,679
	<u>59,184,004</u>	<u>62,613,679</u>

12. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë nga KESH sh.a	5,981,797,534	4,404,803,961
Interesa për t'u paguar	299,867,538	45,687,170
Financime të tjera nga KESH sh.a	177,623,361	
	<u>6,459,288,433</u>	<u>4,450,491,131</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime ndaj furnitorëve	58,529,156	29,127,559
	<u>58,529,156</u>	<u>29,127,559</u>

14. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,211,853	1,200,717
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	877,592	325,836
TVSH për t'u paguar	-	22,300,497
Tatim në burim	19,381	335,470
	<u>2,108,826</u>	<u>24,162,520</u>

15. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Paga për t'u paguar për personelin	3,050,185	3,555,404
Udhëtime dhe dieta		76,000
Honorare ndaj Këshillit Mbikëqyrës	-	159,750
Detyrime ndaj KESH Security sh.a	2,025,696	2,025,696
Detyrime për gjoba	-	14,935,768
Të tjera detyrime	112,742	2,408,762
	<u>5,188,623</u>	<u>23,161,380</u>

16. Të ardhura nga shitja dhe të tjera

Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga kuota fikse	-	1,409,604,000
	-	<u>1,409,604,000</u>

17. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për vitet 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Rimarrje subvencionit për AAM të falura	811,560	961,431
Rimarrje subvencionit për materiale të falura nga italianët	-	1,001,280
Të ardhura të tjera (Arkëtim nga telefonat)	2,879,572	287,720
	<u>3,691,132</u>	<u>2,250,431</u>

18. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Materiale të para	637,278	162,277
Materiale ndihmëse	1,185,075	8,980
Pjesë ndërrimi	2,322,930	929,473
Kimikate	3,981,312	2,518,790
Pajisje sigurie	33,750	91,450
Materiale elektrike	460,360	192,757
Materiale mekanike	205,485	5,491,260
Materiale hidraulike	86,335	108,125
Materiale zyre	-	382,128
Materiale mirëmbajtje të sistemit	442,400	98,733
Materiale për linjën e furnizimit me ujë deti	109,241	79,070
Karburant	2,130,022	2,425,164
Vajra lubrifikantë dhe vajra transformatori	2,455,280	303,300
Inventar i imët	2,975	178,289
Materiale të tjera	981,004	720,559
	<u>15,033,447</u>	<u>13,690,355</u>

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Pagat e personelit	44,393,190	42,390,860
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8,518,253	8,188,746
Shpenzime të tjera për personelin	11,396,230	11,607,229
	<u>64,307,673</u>	<u>62,186,835</u>

20. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime amortizimi	587,072,314	622,018,870
Shpenzime zhvlerësimi	495,468,935	
	<u>1,082,541,249</u>	<u>622,018,870</u>

21. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Blerje energji, avull, ujë	7,663,633	7,151,074
Mirëmbajtje dhe riparime	1,458,100	152,300
Prime te sigurimit	34,000,000	37,790,000
Shpenzime ruajtje dhe sigurie	16,711,680	17,041,650
Personel jashtë njësisë	2,072,917	2,130,000
Transferime, udhëtime e dieta	627,500	402,500
Shpenzime postare e telekomunikacioni	421,808	585,482
Shpenzime transporti	1,217,689	1,192,910
Shërbime bankare	112,972	203,651
Shpenzime për pritje-përcjellje	-	261,500
Shpenzime të tjera	3,525,055	4,466,042
Vlera kontabël neto e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit	-	202,788
Gjoha dhe dëmshpërblime	4,872,435	19,644,778
	72,683,789	91,224,675

22. Shpenzime interesi dhe të ngjashme

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(257,550,017)	(334,176,260)
Të ardhura nga interesat	8,139,743	15,491,987
	(249,410,274)	(318,684,273)

23. Shpenzime të tjera financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga lëvizjet e kursit të këmbimit për të dy vitet 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga kursi i këmbimit	(262,985,950)	(316,038,109)
Shpenzime nga kursi i këmbimit	227,048,458	5,002,677
	(35,937,492)	(311,035,432)

(Vlerat janë në Lek)

24. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e detyrimit për tatimin mbi fitimin paraqitet si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Fitim/ (humbje) para tatimit	(1,516,222,792)	(6,986,010)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	4,872,435	19,906,473
Penalitet, gjoba e demshperblime	4,872,435	19,906,473
Humbje fiskale	(1,511,350,357)	12,920,463
Tatim fitimi @15%	-	1,938,069
	<u>(1,516,222,792)</u>	<u>(8,924,079)</u>

25. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura me impakt në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse paraqiten si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>		<u>31 dhjetor 2014</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të Pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
KESH		14,162,873,616		13,696,755,784
KESH Security		3,696,864		2,025,696
		<u>14,166,570,480</u>		<u>- 13,698,781,480</u>
	<u>31 dhjetor 2015</u>		<u>31 dhjetor 2014</u>	
	<u>Shitje</u>	<u>Blerje</u>	<u>Shitje</u>	<u>Blerje</u>
KESH		7,394,113	1,409,604,000	7,151,074
KESH Security		16,711,680		17,041,650
	<u>-</u>	<u>24,105,793</u>	<u>1,409,604,000</u>	<u>24,192,724</u>

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

(Vlerat janë në Lek)

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

	31 dhjetor	
	2015	2014
Instrumenta me interes fiks		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare		
Instrumenta me interes variable		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	13,676,538,299	13,696,755,784
	13,676,538,299	13,696,755,784

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	11,361,943	865,871,811	-	877,233,754
Mjete monetare në arkë dhe bankë	745,180,253	-	-	745,180,253
Totali	756,542,196	865,871,811	-	1,622,414,007

Përshkrimi	31 dhjetor 2014			
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	866,177,223	-	-	866,177,223
Mjete monetare në arkë dhe bankë	756,315,449	-	-	756,315,449
Totali	1,622,492,672	-	-	1,622,492,672

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2015		
	Deri në 12 muaj	1 - 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	11,361,943	865,871,811	877,233,754
Mjete monetare në arkë dhe bankë	745,180,253		745,180,253
Totali	756,542,196	865,871,811	1,622,414,007
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(65,826,605)		(65,826,605)
Hua	(6,459,288,433)	(5,179,556,118)	(2,515,184,647)
Totali	(6,525,115,038)	(5,179,556,118)	(14,219,855,803)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2015	(5,768,572,842)	(4,313,684,307)	(12,597,441,796)

Përshkrimi	31 dhjetor 2014		
	Deri në 12 muaj	1 - 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	866,177,223		866,177,223
Mjete monetare në arkë dhe bankë	756,315,449		756,315,449
Totali	1,622,492,672	-	1,622,492,672
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(76,451,459)		(76,451,459)
Hua	(45,687,170)	(4,404,803,961)	(13,696,755,784)
Totali	(122,138,629)	(4,404,803,961)	(13,773,207,243)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2014	1,500,354,043	(4,404,803,961)	(12,150,714,571)

TEC Viora sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			Total
	EUR	ALL	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		877,233,754		877,233,754
Mjete monetare në arkë dhe bankë	685,388,712	59,791,541		745,180,253
Totali	685,388,712	937,025,295	-	1,622,414,007
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(21,711,477)	(44,115,128)		(65,826,605)
Hua	(10,989,834,303)	(177,623,361)	(2,986,571,532)	(14,154,029,196)
Totali	(11,011,545,780)	(221,738,489)	(2,986,571,532)	(14,219,855,801)
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2015	(10,326,157,068)	715,286,806	(2,986,571,532)	(12,597,441,796)

Përshkrimi	31 dhjetor 2014			Total
	EUR	ALL	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		866,177,223		866,177,223
Mjete monetare në arkë dhe bankë	692,733,683	63,581,765		756,315,449
Totali	692,733,683	929,758,988	-	1,622,492,671
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	-	(76,451,459)		(76,451,459)
Hua	(10,983,143,082)	-	(2,713,612,701)	(13,696,755,783)
Totali	(10,983,143,082)	(76,451,459)	(2,713,612,701)	(13,773,207,242)
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2014	(10,290,409,399)	853,307,529	(2,713,612,701)	(12,150,714,571)

25. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiarë.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiarë përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrjnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

26. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara


Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

27. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Besnik KENDEZI
Administrator i TECVlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike